

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të
Auditimit të Brendshëm
Internal Audit Knowledge
Elements**

B1

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 14.10.2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</u>
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Total	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

1. Cila nga të mëposhtmet i ndihmon menaxherët e biznesit të ballafaqohen me zgjedhje të vështira etike?
 - A. Qasja përshkruese e etikës.
 - B. Qasja mbi parimet.
 - C. Qasja normative.
 - D. Qasja e testeve etike.
2. Cila nga të mëposhtmet është një aktivitet ligjor?
 - A. Përdorimi i inteligjencës konkurruese.
 - B. Spiunazhi industrial.
 - C. Spiunazhi ekonomik.
 - D. Spiunazhi korporativ.
3. Cila nga të mëposhtmet nuk është një shembull i veprimeve të paligjshme?
 - A. Parregullsitë.
 - B. Mospajtueshmëria.
 - C. Abuzimi.
 - D. Mashtrimi.
4. Cila nga të mëposhtmet bën përpjekje të vlerësojë justifikimet morale themelore për veprimet e korporatave dhe rezultatet pasuese të këtyre veprimeve?
 - A. Deklaratat e ndikimit të biznesit.
 - B. Deklaratat e ndikimit në mjedis.
 - C. Deklaratat e ndikimit në etikë.
 - D. Deklaratat e ndikimit të sigurisë.
5. Në kontekstin e përgjegjësisë sociale, presioni në rritje ndaj korporatave për të bërë më shumë gjëra të mira në cilën nga fushat e mëposhtme të neglizhuara ose të abuzuara?
 - A. Shëndeti dhe mjedisi.
 - B. Konsumatorët dhe punonjësit.
 - C. Kreditorët dhe kontraktorët.
 - D. Furnizuesit dhe shitësit.
6. Transferimi i rrezikut është më i mundshëm për një rrezik me një:
 - A. Shkallë të lartë të diversifikimit dhe një ashpërsi të vogël potenciale.
 - B. Frekuencë të ulët të pritur dhe një ashpërsi të vogël potenciale.
 - C. Frekuencë të lartë të pritur dhe një ashpërsi të lartë potenciale.
 - D. Frekuencë të ulët të pritur dhe një ashpërsi të lartë potenciale.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

7. Përsa i përket menaxhimit të rrezikut, sigurimi duhet të blihet për humbjet e kompanisë që tejkalojnë:

- A. Nivelin e shmangies së rrezikut.
- B. Pasuritë afatshkurtra (qarkulluese).
- C. Humbjet e pritshme.
- D. Nivelin e mbajtjes (ruajtjes).

8. Kostot dhe përfitimet e teknikave të kontrollit duhet të maten në terma monetarë aty ku është e mundur. Cila nga të mëposhtmet është mënyra më efektive për të matur koston e adresimit të kërcënimeve relativisht të shpeshta?

- A. Humbjet në një ngjarje të vetme.
- B. Pritshmëria e humbjeve vjetore.
- C. Humbjet fatale.
- D. Humbjet katastrofike.

9. Cila nga mjetet alternative të transferimit të rrezikut të paraqitura në vijim përdoren më së shpeshti në praktikë?

- A. Metodatat kaptive të sigurimit dhe kontratat e sigurimit financiar.
- B. Politikatat e shumëfishta dhe sekuritizimi i riskut.
- C. Kontratatat e sigurimit shumëpalëshe dhe metodatat kaptive të sigurimit.
- D. Kontratatat e sigurimit shumëvjeçar dhe politikatat e shumëfishta.

10. Cila nga teknikat e mëposhtme të vlerësimit të rrezikut të sigurisë përdor një grup ekspertësh si bazë për marrjen e vendimeve apo gjykimeve?

- A. Auditimi i vlerësimit të rrezikut.
- B. Metoda Delphi.
- C. Sistemet e ekspertëve.
- D. Kërcënimet me bazë skenari.

11. Një firmë afariste me një inventar të mbivlerësuar të stoqeve të vjetëruara mund të përfaqësohet nga cila prej të mëposhtmeve?

- A. Rreziku moral.
- B. Rreziku i kuptimit.
- C. Një rrezik fizik.
- D. Një rrezik ligjor.

12. Nga pikëpamja e menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjes, termi "rrezik" i referohet:

- A. Të njëjtës gjë si rreziku.
- B. Të njëjtës gjë si ekspozimi.
- C. Një gjendje që rrit mundësinë e humbjes.
- D. Pasigurisë në lidhje me humbjen.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

13. Një lloj specifik i organizimit karakterizohet nga ndarja e punës, hierarkia e autoritetit, korniza e rregullave dhe impersonaliteti. Identifikoni llojin e organizimit:

- A. Poshtë-lart.
- B. Sinergjik.
- C. Burokratik.
- D. Finale.

14. Një organizatë që kombinon aderimin e rreptë ndaj unitetit të komandës me ndarje të lartë të punës mund të shkaktojë probleme për klientët që përpiqen të marrin informacion. Nga këto të listuara më poshtë, cili është lloji më i mundshëm i mjedisit të brendshëm që krijon kjo strukturë?

- A. Rrjetëzuar dhe formale.
- B. Fragmentuar (e ndarë në seksione ose kategori) dhe joformal.
- C. Rrjetëzuar dhe informal.
- D. Fragmentuar (e ndarë në seksione ose kategori) dhe formale.

15. Një menaxher i orientuar drejt prodhimit, interes kryesor i të cilit është në përmirësimin e efikasitetit dhe zvogëlimin e humbjeve do të përdorte cilat prej qasjeve të mëposhtme për menaxhimin?

- A. Qasja ndaj sjelljes.
- B. Qasja e sistemeve.
- C. Qasja e kontigjencës.
- D. Qasja operacionale.

16. Një skemë organizative është një shfaqje vizuale e skeletit strukturor të një organizate. Dy dimensione thelbësore të të gjitha skemave të organizimit janë:

- A. Linjat e komunikimit dhe specializimit horizontal.
- B. Hierarkia vertikale dhe specializimi horizontal.
- C. Hierarkia vertikale dhe rëndësia relative e anëtarëve të organizatës.
- D. Linjat e komunikimit dhe rëndësia relative e anëtarëve të organizatës.

17. Menaxhimi i një kompanie që mirret me shërbime financiare është duke marrë parasysh një vendim strategjik lidhur me zgjerimin e rrjetit ekzistues të zonës lokale për të përmirësuar funksionin e shërbimit për klientët e firmës. Cila nga aspektet e mëposhtme të sistemit të zgjeruar është çështja strategjike më pak e rëndësishme për menaxhimin?

- A. Si sistemi i zgjeruar mund të kontribuojë në planin afarist afatgjatë të bizneseve.
- B. Si do të mbështeste sistemet e përditshme të biznesit.
- C. Si treguesit mund të zhvillohen për të matur se sa mirë i arrin objektivat e biznesit sistemi i zgjeruar.
- D. Si sistemi i zgjeruar do të kontribuojë në zvogëlimin e kostove operative.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

18. Cila nga të mëposhtmet ka një strukturë organizative të sheshtë në krahasim me të tjerët?
- A. Organizata A me njëmbëdhjetë nivele hierarkike.
 - B. Organizata B me tre nivele hierarkike.
 - C. Organizata C me tetë nivele hierarkike.
 - D. Organizata D me gjashtë nivele hierarkike.
19. Cila nga të mëposhtmet ndan funksionet kryesore të një organizate në kompani të veçanta?
- A. Struktura e ndarjes.
 - B. Struktura e ekipit.
 - C. Struktura e rrjetit.
 - D. Struktura e matricës.
20. Për shkak se departamentet shkëmbejnë burime dhe varen nga njëra-tjetra për të performuar mirë, cila nga të mëposhtmet është një ndërvarësi më e madhe?
- A. Ndërvarësia reciproke.
 - B. Ndërvarësia sekuenciale.
 - C. Ndërvarësia e bashkuar.
 - D. Ndërvarësia horizontale.
21. Cila nga të mëposhtmet ka një fokus të jashtëm (dukshëm)?
- A. Vendndodhja gjeografike.
 - B. Funksioni.
 - C. Procesi i punës.
 - D. Produkti-shërbimi.
22. Në organizatat ku shpesh krijohen grupe produktesh të reja, një strukturë që kombinon departamentizimin e produkteve dhe funksional dhe krijon linja të dyfishta të autoritetit (të kompetencës, besimit) do të ishte optimale. Struktura më e mirë për këtë organizatë do të ishte:
- A. Burokraci profesionale.
 - B. Mekanistike.
 - C. Matricë.
 - D. Burokraci makinerike.
23. Dëgjuesit e mirë shfaqin të gjitha karakteristikat e mëposhtme përveç:
- A. Të bërit pyetje.
 - B. Të bërit të paragjytimeve.
 - C. Tolerimi i zakoneve të këqija.
 - D. Të gjykuarit e përmbajtjes, jo gabimet e shpërndarjes.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

24. Në një organizatë organike, komunikimi ka tendencë të jetë:

- A. Lateral.
- B. Lart posht.
- C. Vertikale.
- D. Posht lart.

25. Cili lloj i strategjisë së rritjes zakonisht lidhet me firmat që kanë një strukturë funksionale?

- A. Zhvillimi i tregut.
- B. Zhvillimi i produktit ekzistues.
- C. Penetrimi i tregut.
- D. Zhvillimi i produkteve të reja.

26. Aktivitetet mbështetëse të zinxhirit të vlerës përfshijnë cilat nga të mëposhtmet?

- A. Magazinimi.
- B. Transportimi.
- C. Shitjet dhe instalimi.
- D. Administrimi.

27. Cili lloj i centralizimit zakonisht gjendet në strukturën matricë të projektit?

- A. Decentralizuar.
- B. Shumë e decentralizuar.
- C. Shumë e centralizuar.
- D. Decentralizuar me ndarje.

28. Cila nga firmat e mëposhtme i kushton vëmendje efikasitetit të operacioneve aktuale?

- A. Mbrojtësit.
- B. Kërkuesit.
- C. Analizuesit.
- D. Reaktorët.

29. Cila nga të mëposhtmet më së miri përshkruan evolucionin tipik të strategjisë së nivelit korporativ për një kompani?

- A. Përqendrimi, integrimi vertikal, diversifikimi, ristrukturimi.
- B. Ristrukturimi, diversifikimi, integrimi vertikal, përqendrimi.
- C. Përqendrimi, diversifikimi, ristrukturimi, integrimi vertikal.
- D. Integrimi horizontal, diversifikimi, integrimi vertikal, ristrukturimi.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

30. Disa produkte anashkalojnë cilën nga fazat e mëposhtme të integrimit vertikal?

- A. Nxjerrja e lëndëve të para.
- B. Prodhimi primar.
- C. Prodhimi përfundimtar.
- D. Shitje me shumicë dhe / ose pakicë.

31. Penetrimi i tregut nënkupton cilën nga këto?

- A. Kombinimi i integrimit vertikal me integrimin horizontal.
- B. Rritja e pjesës së tregut përmes reklamimit, promocioneve ose rritjes së përpjekjeve për shitje.
- C. Formimi i një aleance strategjike me një firmë në një biznes të ri.
- D. Sigurimi i një organizate në të njëjtën linjë biznesi.

32. Enkriptimi përdoret për të zvogëluar probabilitetin e zbulimit të paautorizuar dhe ndryshimeve në informata kur një sistem është në cilin nga këto sisteme të sigurta dhe gjendje jo të operueshme?

- A. Riparimin (zgjidhjen e problemit).
- B. Jashtë-linje (offilne) për mirëmbajtje.
- C. Mbushja e sistemit operativ në kujtesën kryesore të kompjuterit (Boot-up).
- D. Mbyllja.

33. Cila nga veprimet e mëposhtme të përdoruesit lejohet pa identifikim ose autentifikim (vërtetim/validim)?

- I. Qasja në faqet e internetit publike.
- II. Situatat e urgjencës (emergjente).
- III. Përpjekjet e pasuksesshme të identifikimit.
- IV. Rivendosja e një bllokimi të seancës.

- A. Vetëm I.
- B. Vetëm II.
- C. I dhe II.
- D. III dhe IV.

34. Nga pikëpamja e vendimit të kontrollit të qasjes, dështimet për shkak të defekteve në sistemet e bazuara në leje (autorizim) kanë tendencë të bëjnë cilën nga këto?

- A. Veprimet e lejuara të autorizuar.
- B. Dështim-kthim në gjendje të sigurt (Fail-safe) me leje të refuzuar.
- C. Veprimet e ndaluara të paautorizuara.
- D. Dhënia e lejeve të paautorizuara.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

35. Një kombinim i diçkaje që keni (një herë), diçka që keni (herën e dytë), dhe diçka që ju e dini përdoret për të pasqyruar cilën nga skemat e mëposhtme të autentifikimit (vërtetimit/validimit) personal?
- A. Një autentifikim (vërtetim/validim) me një faktor.
 - B. Një autentifikim (vërtetim/validim) me dy faktorë.
 - C. Një autentifikim (vërtetim/validim) me tre faktorë.
 - D. Një autentifikim (vërtetim/validim) me katër faktorë.
36. Për menaxhimin e fjalëkalimeve, cili prej të më poshtmeve siguron 'forcën' e fjalëkalimit?
- A. Fjalëkalimet me hapësirën maksimale të çelësave, karaktere më të shkurtra, dekompozim i ulët i karaktereve dhe fjalëkalime të thjeshta.
 - B. Fjalëkalimet me hapësira të ekuilibruar të çelësave, karaktere më të gjata, dekompozim i lartë i karaktereve dhe fjalëkalime komplekse.
 - C. Fjalëkalimet me hapësira minimale të çelësave, karaktere më të shkurtra, dekompozim i lartë i karaktereve dhe fjalëkalime të thjeshta.
 - D. Fjalëkalimet me hapësira më të mundshme të çelësave, karaktere më të gjata, dekompozim i ulët i karaktereve dhe karaktere komplekse.
37. Cila nga këto nuk është një mekanizëm autentifikimi (vërtetimi/validimi)?
- A. Çfarë di përdoruesi.
 - B. Çfarë ka përdoruesi.
 - C. Çfarë mund të bëjë përdoruesi.
 - D. Çfarë është përdoruesi.
38. Si ndryshon autorizimi nga autentifikimi (vërtetimi/validimi)?
- A. Autorizimi vjen pas autentifikimit.
 - B. Autorizimi dhe autentifikimi (vërtetimi/validimi) janë të njëjta.
 - C. Autorizimi është verifikimi i identitetit të përdoruesit.
 - D. Autorizimi vjen përpara autentifikimit (vërtetimit/validimit).
39. Cila nga të mëposhtmet është një funksion i papërshtatshëm për një administrator të bazës së të dhënave (DBA)?
- A. Administrimi i të dhënave.
 - B. Administrimi i sistemeve të informacionit.
 - C. Siguria e sistemeve.
 - D. Planifikimi i sistemeve të informacionit.
40. Disa autoritete të sigurisë besojnë se ri-autentifikimi i çdo transaksioni siguron procedura më të forta sigurie. Cila nga mekanizmat e mëposhtëm të sigurisë është më pak efikase dhe më pak efektive për ri-autentifikim?
- A. Fjalëkalimet përsëritëse.
 - B. Fjalëkalimet që nuk përsëriten.
 - C. Shenja (tokeni) i kujtesës.
 - D. Shanja (tokeni) i zgjuar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

41. Një mekanizëm i sistemit dhe gjurma e auditimit i ndihmojnë menaxherët e biznesit që t'i mbajnë përgjegjës përdoruesit individualë për veprimet e tyre. Për të përdorur këto gjurmë të auditimit, cili nga kontrollet e mëposhtme është një parakusht që mekanizmi të jetë efektiv?

- A. Fizik.
- B. Mjedisit.
- C. Menaxhimi.
- D. Qasja logjike.

42. Cila nga këto është një problem i veçantë i raportimit lidhur me përcaktimin e rezultateve të operacioneve (fitimit kontabël) për një periudhë të ndërmjetme?

- A. Shpenzimet e reklamimit dhe shpenzimet e ngjashme të shpenzuara në një periudhë të ndërmjetme mund të kenë efekt përfitues edhe në periudha të tjera të ndërmjetme për të njëjtin vit kontabël.
- B. Kostoja e mallrave të shitura për një periudhë të ndërmjetme pasqyron vetëm shumën e kostos së produktit që zbatohet për të ardhurat e shitjeve të njohura në periudhën e ndërmjetme.
- C. Zhvlerësimi për një periudhë të ndërmjetme përfaqëson një vlerësim.
- D. Një humbje e jashtëzakonshme që ndodh në tremujorin e dytë duhet të jetë e shpërndarë gjatë tre periudhave të kaluara të të njëjtit vitit kontabël.

43. Kur përdoret një sistem i inventarizimit (stoqeve) të përhershëm dhe ekziston një dallim midis saldos së shumës së inventarit (stoqeve) të përhershme dhe numrit të inventarit (stoqeve) fizike, nevojitet një hyrje e veçantë për të rregulluar shumën e inventarit (stoqeve) të përhershme. Cila nga të mëposhtmet tregon atë hyrje korrigjuese?

I. Mbi dhe nën inventarizimi

Inventari (stoqet)

II. Humbja e jashtëzakonshme për shkak të shlyerjes së inventarit (stoqeve)

Inventari (stoqet)

III. Humbja e jashtëzakonshme për shkak të shlyerjes së inventarit

Lejimet për shkurtime (zvogëlimet) e inventarit (stoqeve)

IV. Kostoja e mallrave të shitura

Fitimet e pashpërndara të ndara për shkurtime (zvogëlimet)

- A. I.
- B. II.
- C. III.
- D. IV.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! Nga 2 pikë secila

44. Auditim i një kompanie ka zbuluar katër gabimet e mëposhtme që kanë ndodhur por nuk janë korrigjuar:

Inventari (Stoqet) më 31 dhjetor 2011 - 40,000€, nënvlerësuar.

Inventari (Stoqet) më 31 dhjetor 2012 - 15,000€, mbivlerësuar.

Shpenzimet akruale më 31 dhjetor 2012 - 10,000€, nënvlerësuar.

Gabimet bëjnë që të fitimi neto i raportuara për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012 të jetë:

A. Mbivlerësuar për 72,000€.

B. Mbivlerësuar 65,000€.

C. Nënvlerësuar 28,000€.

D. Nënvlerësuar për 45,000€.

45. Më 1 janar 2012, një kompani bleu një pasuri bimore për 300,000€. Duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit për jetëgjatësinë prej 10 vjetësh dhe pa vlerë të mbetur, kompania regjistroi zhvlerësimin prej 30,000€ për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Vlera e drejtë e pasurisë më 31 dhjetor 2012 është 310,000€. Bilanci i Gjendjes (Pasqyra e Pozitës Financiare) e përgatitur më 31 dhjetor 2012, do të:

A. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si emër të mirë (goodwill).

B. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si pjesë e impianteve dhe pajisjeve.

C. Raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra si kapital vlerësues.

D. Të mos raportoje dallimin ndërmjet vlerës së drejtë me vlerën neto në libra.

46. Shënimet e pasqyrave financiare në vijim janë ekstrakte nga pasqyrat financiare të audituara të kompanive publike. Cili shënim përshkruan një ndryshim në vlerësimin kontabël?

A. Korporata ka ndryshuar zhvlerësimin e pasurive kapitale bazuar në rivlerësimin e jetës së dobishme të pasurisë. Prandaj, korporata ndryshoi normën e zhvlerësimit nga 5% dhe 6%, në 8% dhe 10%, për makineri dhe pajisje.

B. Para vitit 2011, impiantet dhe pajisjet (përveç pjesëve zëvendësuese të shërbimit të klientit) u zhvlerësuan me metodën e saldove zbritëse. Impiantet dhe pajisjet tani zhvlerësohen me metodën drejtvizore.

C. Gjatë vitit, kompania ndryshoi metodën e saj të kontabilitetit për huatë që nuk kanë lidhje me interesat, të paguara nga punonjësit, në përputhje me një ndryshim në parimet kontabël të pranuar përgjithësisht.

D. Nga 1 janar 2012, kompania ndryshoi metodën e përcaktimit të kostos së stoqeve në LIFO. Para vitit 2012, u përdor metoda FIFO.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.
Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë! **Nga 2 pikë secila**

47. Cila nga thëniet e mëposhtme është një përshkrim i saktë i regjistrimeve kontra (stornimeve)?
- A. Kontabilizimi i regjistrimeve kontra (stornimeve) është një hap i detyrueshëm në ciklin e kontabilitetit.
 - B. Regjistrimet kontra (stornimet) bëhen në fund të periudhës së ardhshme të kontabilitetit, pas regjistrimit të transaksioneve të rregullta të periudhës.
 - C. Regjistrimet kontra (stornimet) janë identike me shënimet e rregullimit të bëra në periudhën e mëparshme.
 - D. Regjistrimet kontra (stornimet) janë e kundërta e rregullimeve (korrigjimeve) të bëra në periudhën e mëparshme.**
48. Më 31 dhjetor, një kompani pranoi një parapagim për qira të hapësirës për zyre për vitin e ardhshëm. Në kohën e pranimit, hyrja e bërë ishte një debi për paranë e gatshme dhe një kredi për shpenzime të qirasë. Librat për vitin ende nuk janë mbyllur. Për të regjistruar siç duhet pranimin e parasë më 31 dhjetor dhe korrigjuar gabimin, hyrja e nevojshme shtesë në ditar do të ishte:
- A. Asnjë hyrje nuk kërkohet.
 - B. Debitimi i shpenzimeve të qirasë, kreditimi i të ardhurave nga qiraja.
 - C. Debitimi i parasë së gatshme, kreditimi i të hyrave të pafituara nga qiraja.
 - D. Debitimi i shpenzimeve të qirasë, kreditimi i të hyrave të pafituara nga qiraja.**
49. Çfarë lloj kulture mbizotëron në Shtetet e Bashkuara?
- A. Konteksti i ndryshueshëm dhe kolektivist.
 - B. Konteksti i ulët dhe individualist.**
 - C. Konteksti i lartë dhe kolektivist.
 - D. Konteksti fiks dhe individualist.
50. Kur menaxhoni në një mjedis global dhe në një shoqëri të orientuara në marrëdhëniet, udhëheqësit e biznesit duhet të bëjnë cilën nga të mëposhtmet?
- A. Kanë një interes të fortë personal për punonjësit.**
 - B. Ndjehen të lirë të kritikojnë aq sa ndjejnë se ka nevojë.
 - C. Kundërshtojnë në publik sa herë të jetë e mundur.
 - D. Minimizojnë theksin në marrëdhëniet personale.